“Ai që i mëson përmendsh dhjetë ajetet e para të sures Kehf, do të jetë i mbrojtur nga (sprova e) Dexhallit.”

Ebu Derdai (Allahu qoftë i kënaqur me të!) transmeton se Profeti ﷺ ka thënë: “Ai që i mëson përmendsh dhjetë ajetet e para të sures Kehf, do të jetë i mbrojtur nga (sprova e) Dexhallit.”

[Sahih] [Transmeton Muslimi]

Profeti ﷺ në këtë hadith tregoi se kush i mëson përmendsh dhjetë ajetet e para të sures Kehf, do të ruhet, do të mbrohet dhe do të jetë i siguruar nga sprova e mesihut Dexhall, i cili do të shfaqet në fund të kohës dhe do të pretendojë se është zot. Sprova e tij do të jetë sprova më e madhe që ka përjetuar toka, që nga krijimi i Ademit e deri në Ditën e Kiametit, për shkak të veprimeve të jashtëzakonshme që Allahu i Lartësuar do t’ia mundësojë atij, për të mashtruar ndjekësit e tij. Kjo, ngase në fillim të sures Kehf ka tregime dhe argumente madhështore, që janë më të mëdha sesa ato që Dexhalli do të përdorë për të hutuar njerëzit. Kështu, kush mendon e mediton mbi to, nuk do të mashtrohet prej tij. Në një transmetim tjetër, thuhet se janë dhjetë ajetet e fundit të kësaj sureje, që fillojnë me fjalën e Allahut: "A mos mendojnë jobesimtarët se mund t’i marrin robërit e Mi për mbrojtës përveç Meje..."

https://sunnah.global/hadeeth/sq/show/6265

النجاة الخيرية
ALNAJAT CHARITY
لجنة الدعوة الإلكترونية
EDC E-Da'wah Committee